



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 360/18

Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data / Datum 27. 12. 2018

VUSHTRRI - VUČITRN




**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës -Vushtrri**


Në mbështetje të nenit 12, paragrafit 2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 41, paragrafit 2, pika "ç" e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 10, paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, si dhe duke u mbështetur në propozimin e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike, për shkarkimin e anëtarit të komitetit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 dhjetor 2018** mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR SHKARKIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT KONSULTATIV**

- 1.Me këtë vendim, z. Emin Salihu shkarkohet nga detyra e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike, i cili duke mos arsyetuar mungesën e tij, ka munguar në disa mbledhje radhazi në komitetin e lartcekur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesi i kuvendit, Njësia e personelit dhe Sekretaria e kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**Nasuf Aliu**

  
**Kryesues i Kuvendit**



REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 364/18

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data / Datum 27.12.2018

VUSHTRRI - VUČITRN




## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës -Vushtrri


Në mbështetje të nenit 12, paragrafit 2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, nenit 41, paragrafit 2, pika "ç" e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 10, paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, si dhe duke u mbështetur në propozimin e Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta, për shkarkimin e anëtarit të komitetit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 dhjetor 2018** mori këtë:

### VENDIM PËR SHKARKIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT KONSULTATIV

- 1.Me këtë vendim, z. Edmond Krasniqi shkarkohet nga detyra e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta, i cili duke mos arsyetuar mungesën e tij, ka munguar në disa mbledhje radhazi në komitetin e lartcekur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesi i kuvendit, Njësia e personelit dhe Sekretaria e kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu  
  
Kryesues i Kuvendit





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës - Vushtrri**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **27 dhjetor 2018**, mori këtë:

**VENDIM  
PËR APROVIMIN E RAPORTIT PËR IMPLEMENTIMIN E PLANIT TË  
INTEGRITETIT**

1. Me këtë vendim aprovet Raportit për Implementimin e Planit të Integritetit për vitet 2016-2018 i Komunës së Vushtrrisë.
2. Qëllimi i nxjerrjes së këtij vendimi, është aprovimi raportit lidhur me planin e integritetit, i cili ka për objektive forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në shpenzimin e parasë publike.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendim është dokumenti me emërtimin Raporti për Implementimin e Planit të Integritetit për 2016-2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**



**Kryesues i Kuvendit**